



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 17.6.2015 ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina, Kujtim Paçaku, dhe Pal Lekaj.

Munguan: Zafir Berisha dhe Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë: Mahir Yagcilar, ministër i Ministrisë së Administratës Publike dhe përfaqësuesit e MAP-së, përfaqësuesit e BIRN-it, GAP-it, NDI-së dhe OSBE-së.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina, Mirjeta Heta dhe Flaka Zairi, praktikante në Komision, nga UNDP-ja.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.6 dhe 11.6.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2014;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara

Procesverbalet e dt. 3.6 dhe 11.6.2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2014

Zenun Pajaziti, theksoi se një ndër prioritet e Qeverisë është zhvillimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, dhe me ndryshimin e legjislacionit në fuqi, reforma shtetërore, do të mund ta përmirësojë gjendjen aktuale të shërbyesve civilë, në mënyrë që të përcaktohen objektivat për ngritjen e nivelit të administratës publike.

Ai, pastaj ia dha fjalën ministrit Yagcilar dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që pyetjet dhe diskutimet e tyre të jenë të fokusuara vetëm lidhur me raportin.

Mahir Yagcilar, reforma për shërbimin civil ka filluar në vitin 2007, kur edhe është filluar me Strategjinë për administratën publike, e cila strategji pastaj është konkretizuar edhe me hartimin e legjislacionit primar për shërbimin civil, si Ligji për shërbimin civil, Ligji për pagat e nëpunësve civilë dhe Ligji për administratën shtetërore. Kjo kornizë ligjore ka mundësuar reformimin praktik të shërbimit civil. Sa i përket raportit, përmban gjendjen faktike të shërbimit civil, për vitin 2014.

Xhevahire Izmaku, tha se raporti është dashur të jetë më i detajuar, pasi që ekziston një avancim i administratës publike. Ajo pyeti lidhur me inkuadrimin e personave me aftësi të kufizuara dhe strategjia e re për trajnimin e këtyre punëtorëve se a është mbështetur nga IKAP-i apo DASHC-i.

Ndërsa, rekrutimi i gjinisë femërore dhe i komunitetit joserb, sipas legjislacionit në fuqi, mbetet i pazbatuar sa i përket kuotës, sidomos në nivelin lokal. Si realizohet vlerësimi i performancës së shërbyesve civilë, do të jetë i dobët nga udhëheqësit e departamenteve dhe a ka ndikuar udhëzimi administrativ për vlerësim të performancës? Pse ekziston një dallim për shërbyesit civilë të nivelit qendror dhe lokal rreth kërkesave për trajnime?

Alma Lama, pyeti: Strategjia për shërbimin civil, a është realizuar nëpërmjet IKAP-it dhe Fondi për Kuadrot, si është shfrytëzuar, a është raportuar lidhur me Fondin për Kuadro dhe cilët kuadro kanë përfituar?

Shqipe Pantina, theksoi se duke iu referuar raportit të vitit 2011, 2012 dhe raportit të KPMSHCK-së, ekziston një dallim në aspektin analitik. - Cilat janë sfidat që kanë shërbyesit civilë? Raporti i këtij viti është i bazuar në një pyetësor kryesisht me të dhëna. Ajo pyeti: A janë vërtetuar këto të dhëna dhe pse pyetësori nuk i është bashkëngjitur raportit? Cilat janë aktivitetet e arritura sipas raportit dhe çfarë rezultatesh kanë këto aktivitetet? A janë mbështetur nga donatorët, meqë raporti nuk ka të dhëna për rezultatet, analizat, sfidat? Cilat ishin sfidat gjatës kohës kur është hartuar raporti dhe si do të bëhet përmirësimi i gjendjes në shërbimin civil? Çfarë funksioni kanë 374 punëtorët me arsim fillor të nivelit lokal dhe pse ka rënë numri i të punësuarave, të gjinisë femërore? Po ashtu, ajo shprehu shqetësimet për vlerësimin e performancës dhe mospërshkrimin e vendeve të punës, rreth trajnimeve të njëjta të ofruara nga IKAP-i. Si është vendosur për temat e njëjta të trajnimeve dhe a është rritur efikasiteti nga këto trajnime? Kush ka përfituar nga Fondi për Kuadro dhe çfarë niveli akademik kanë pasur këta përfitues? Janë shqetësuese dallimet në raportet e MAP-së dhe KPMSHCK-së.

Kujtim Paçaku, shprehu shqetësimin e tij për komunitetin joserb dhe pyeti: Sa pjesëtarë të këtij komuniteti janë pjesë e komunave në zyrat për komunitete?

Pal Lekaj, tha se raporti është përshkrim i raporteve nga vitet e kaluara. Pyeti: Si janë emëruar shërbyesit civilë në pozita udhëheqëse dhe cilat janë shkeljet gjatë procedurave të rekrutimit? Si bëhet matja e performancës për shërbyesit civilë? Pse janë në rritje kontratat mbi vepër? Gjithashtu, përkrahu diskutimet e anëtarëve të Komisionit lidhur me Fondin për Kuadro.

Sadri Ferati, shprehu shqetësimin e tij për gjendjen aktuale të shërbyesve civilë dhe theksoi se duhet të bëhet racionalizimi i administratës publike dhe të ekzistojë një dallim funksional midis MAP-së dhe administratës publike, ku në raport nuk ceket.

Mahir Yagcilar, tha se ne jemi në fazën e verifikimit të kualifikimit të shërbimit civil. Të gjitha vërejtjet e parashtruara që nuk janë të përfshira në raport, janë planifikuar në Strategjinë për reformën e administratës publike dhe planin e veprimit të strategjisë.

Si çështje kruciale mbetet Ligji për pagat e nëpunësve civil, klasifikimi i vendeve të punës, ndërsa sa i përket dallimeve në raportet e MAP-së dhe KPMSHCK-së, ata në raport përfshijnë punën sipas kërkesave, ankesave të shërbyesve civilë, sipas mandatit që kanë, ndërsa MAP-ja në raport i inkorporon të realizuarat vjetore.

Zenun Pajaziti, kërkoi nga ministri që raporti për Kuvend, të plotësohet me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit. Ai rekomandoi që raporti të votohet.

Konstatim:

Me shumicë votash për dhe një kundër nga znj. Shqipe Pantina, Komisioni nxori rekomandimin si vijon:

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17.6.2015, shqyrtoi Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2014 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2014.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës i raporton Kuvendit të paktën një herë në vit për gjendjen në shërbimin civil.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 17.6.2015, shqyrtoi Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2014 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,
Zenun Pajaziti**
